

Njeriu që qëllloi në mars të këtij viti mbi dijetarin dhe predikuesin e dalluar saudit Aid el-Karni gjatë një vizite të tij në Filipine ishte një anëtar i Hezbollahut filipinas.

Shejh El-Karni u qëllua ndërsa po dilte nga një universitet shtetëror në Zamboanga, ku sapo kishte mbajtur një leksion. Ai arriti t'i mbijetonte atentatit, por u plagos prej atentatorit.

Pas tre muajsh qëndrimi në spitalet filipinase dhe saudite për shkak të plagëve, ai ka dhënë një intervistë për Arab News-in, ku dhe ka treguar mbi përkatësinë e personit që e qëllloi.

“Disa hetues më thanë, kur po kurohesha në Filipine, se hetimet paraprake tregonin që atentatori i vrarë në incidentin tim ishte një anëtar filipinas shiit i Hezbollahut, e se kishte qenë një vizitor i rregullt i qendrës kulturore iraniane ku propagandohej zakonisht kulti shia, e ku ngrihej lart avokatia e Iranit,” ka rrëfyer ai.

Dijetari ka thënë gjatë intervistës së tij se nuk do të ngurronte të shkonte sërish në Filipine për të predikuar.

“Vdekja mund t'i vijë çdokujt, në çdo kohë, edhe kur gjendet në shtrat,” ka arsyetuar el-Karni. /tesheshi/